



## Enver Hoxha ka qenë për bashkimin e Kombit prej vitit 1936 gjërë ne vdekje



Kushtuar 100 vjetorit të lindjes

Gjyshi i E. Hoxhës (Beqiri) ka qenë anëtar i Lidhjes së Prizrenit për Gjirokastrë. Xhaxhai i E. Hoxhës (Hyseni) Baba Çeni siç e quante Enver Hoxha, ka qenë përfaqësues nga Gjirokastra në qeverinë e Ismail Qemallit.

E. Hoxha pas kthimit në atdhe nga Brukseli në verën e vitit 1936 betohet para varrait të patriotit Bajo Topulli për bashkim kombëtar.

Dy muaj më vonë E.Hoxha mori pjesë në gjetjen e eshtrave të patriotëve Çerçiz Topulli e Muç Çulli në fushën e Shtoit dhe mbajti një fjalim para popullit të Shkodrës.

Po këtë vit (1936) në Gjirokastrë E.Hoxha lidhet me Ali Kelmendin nga Peja njërin nga themeluesit kryesorë të lëvizjes komuniste në Shqipëri.

Enver Hoxha pas bashkimit të grupeve komuniste në Shqipëri , më 8 nëntor 1941 në Tiranë krijon PKSH-në edhe me kosovarë.

Pas dy jave më 23 nëntor '41 E.Hoxha themelon organizatën e Rinisë Komuniste të Shqipërisë po në Tiranë, në shtëpinë e patriotes kosovare Sabrie ( Bije Vokshit) nga Gjakova mbesa e Sylejman Vokshit dhe halla e Asim Vokshit.

Bije Vokshi ishte luftetare e veprimtare e Komitetit për mbrojtjen kombetare të Kosovës, pastaj ishte komuniste e grupit të Shkodrës. Shtëpia e B.Vokshit ishte bazë e ilegalitetit ku Bija pergaditete ushqimin, lante rrobat e ushtarëve dhe aty strehohej edhe E.Hoxha.

Më 1942 B.Vokshi u dërgua në Kosovë për të ndihmuar org. e luftës ANÇ të popullit kosovar. Bije Vokshi ishte delegate në Konferencën e Bujanit (1943-4), aty foli në emër të grave antifashiste të Kosovës.

Në Shqipëri para LDB-së dhe gjatë fillimit të saj ishin rreth 100 patriotë-komunistë shqiptarë kosovarë dhe shqiptarë tjerë nga viset shqiptare të Jugosllavisë për t'u shkolluar atje. Edhe këta atje shumica ishin në grupet komuniste sdm. të Shkodrës. Edhe këta më kryesorët mbanin lidhje me E.Hoxhën, H.Lleshin, G.Nushin etj. Takimet bëheshin sdm. në shtëpinë e Bije Vokshit. Edhe këta u dërguan në Kosovë për të ndihmuar LANC.

Enver Hoxha u bë iniciatori dhe drejtuesi i gazetës "Zërit i popullit" organit të KQ të PKSH në numrin e parë të kësaj gazete shkruhet për Kosovën (25 gusht 1942) Enver Hoxha zgjodhi Ramadan Çitakun nga Mitrovica anëtar të K.Q të Përkoshëm të PKSH. R.Çitaku ishte pjestarë i Mbledhjes së përfaqësuesve të Grupeve kryesore komuniste për Themelimin e PKSH (1941). R.Çitaku në Konf. e parë të Vendit të PKSH 1943 u zgjodhë antar i KQ të

PKSH dhe i Byrosë Politike. Gjatë LANÇSH R.Çitaku u zgjodh anëtar i Shtabit të përgjithshëm të UNÇ. Në konferencën e Labinotit 1943 R.Çitaku u zgjodh anëtar i Kryesisë së Këshillit të Përgjithshëm NÇ. Në Kongresin e Përmetit 1944 R.Çitaku u zgjodh anëtar i komitetit ANÇ me detyrë i ngarkuar me punën e financave. Pas çlirimit R.Çitaku ishte anëtar i Presidiumit të Kuvendit Popullor dhe ministër i financave (1945-8). R.Çitaku ishte përfaqësues i RP. Të Shqipërisë në vende të huaja. Në Shqipëri pas R.Çitakut në ministri kishte edhe shqiptarë tjerë nga Jugosllavia.

Enver Hoxha ishte përkrahës i Konferencës së Bujanit për bashkim kombëtar ku për organizimin e saj ndihmuan organizata e PKSH për Tropojën si dhe komanda dhe organizata e partisë e batalionit "Perlat Rexhepi" të Shkodrës.

Në shtator 1944 E.Hoxha u dha urdhër Brigadës V dhe III Sulmuese të UNÇSH të kalonin në Kosovë për të ndihmuar në çlirimin e saj nga pushtuesit gjermanë. Dy muaj më vonë, "Divizionet e Pestë dhe Gjashtë të UNÇSH, menjherë pas çlirimit të plotë të Shqipërisë vazhduan ndjekjen e trupave hitleriane në Jugosllavi, ku së bashku me repartet e UNÇJ, gjatë muajve dhjetor 1944 dhe janar-shkurt 1945, e çliruan Malin e Zi, Sanxhakun, dhe pjesën jugore të Bosnjës.

Enver Hoxha në fund të qershorit 1946 me delegacionin e vet shkon në Jugosllavi (Beograd) te Tito për të kërkuar Kosovën dhe viset e tjera shqiptare në Jugosllavi për t'u ribashkuar Shqipërisë. Tito me dredhite e tij i përgjigjet Enverit, kinse për momentin serbët nuk do të na kuptojnë, kurse në anën tjetër jugosllavët insistonin që edhe Shqipërin ta bënin republikë të shtatë, siç ndodhi më 1947 divizionet jugosllave tentuan të futen në Shqipëri, kinse ajo është rrezikuar nga Greqia. E.Hoxha për këtë e lajmëron Stalinin dhe Stalini i del në ndihmë Shqipërisë.

Më 1948 Enver Hoxha i ndërpret marrëdhëniet me Jugosllavinë ashtu Stalini e përjashtoi Jugosllavinë nga Kampi Socialist nga të gjitha shtetet komuniste. Nga viti 1947 E.Hoxha u takua pesë herë me Stalinin.

Në shtator 1946, në krye të delegacionit shqiptarë në Konferencën e Paqës në Paris, E.Hoxha shpreh vullnetin e popullit shqiptarë në mbrojtje të interesave e të drejtave të veta dhe demaskon botërisht synimet aneksioniste të shovenistëve fqinjë... Në shërbim të këtyre synimeve që gjat viteve të LANÇ udhëheqësit jugosllavë dhe të dërguarit e tyre në Shqipëri... tentuan për ta eliminuar nga udhëheqja sdm. Enver Hoxhën.

Po pas vdekjes së Stalinin jugosllavët dhe rusët i përmirësojnë marrëdhëniet (Tito dhe Hrushqovi) u munduan ta eliminonin Enver Hoxhën nga skena politike.

Enver Hoxha, në fillim të viteve '60 i ndërpret marrëdhëniet me BRSS-në, e përze floten sovjetike nga Shqipëria dhe del nga Traktati i Varshavës.

Enver Hoxha në nëntor 1960 në Moskë merr pjesë në Mbledhjen e 81 Partive Komuniste të Botës, aty Enver Hoxha e sulmon ashpër Hrushqovin, këtu i del në ndihmë delegacioni kinez. Nga ky moment fillon rregullimi i marrëdhënieve Shqipëri-Kinë rreth një decenie. Po me përmirësimin e marrëdhënieve Kinezo-Jugosllave, Enver Hoxha i ndërpret marrëdhëniet edhe me Kinën. Atëherë Shqipëria ishte bërë e fortë, quhej fuqi baruti në Ballkan, kurse Jugosllavia i thoshte vetës Fuqia e Shtatë në Botë.

Që pas luftës Enveri dërgoi në Kosovë rreth 200 mësues, libra etj. megjithëse Shqipëria kishte nevojë për vete, po në vitet e 70-ta Enveri dërgoi mbi 200 profesorë të Universitetit.

Sipas "Tanjugut" vetëm prej vitit 1948 deri në vitin 1960 udhëheqësit dhe shtypi shqiptar mesatarisht dy herë në ditë sulmonin Jugosllavinë.

Po i cekë vetëm tre autorë rreth burgosjes dhe pushkatimeve në Shqipëri dhe në Botë, libri; Insknimet... nga Georges Herman Hodos (Proceset politike dhe spastrimet staliniste në Evropën Lindore 1948-1956) bot. Tiranë 2000. Në këtë libër shkruhet Shqipëria së paku ka patur të burgosur dhe të vrarë (të pushkatuar).

Libri; Smrt u Prisustvi Vlasti -Smrtna kazna u Jugoslaviji svetu. aut. Ivan Jankovic, bot. Beograd 1985. Në këtë libër fq. 195 shkruhet nga viti 1944-1951 izvorsene smrtne kazne 469 (janë kryer dënime me vdekje 469). Po aty fq.74 në Shqipëri janë kryer 40 dënime me vdekje.

Libri, Historia e Burgjeve të Shqipërisë gjatë shek. XX. Nga Femi Sufaj bot. Tiranë 2000, fq. 127 shkruan të burgosur gjithësej në Shqipëri 3342 viti 1962 (shumica ordinerë) Gjendja gati e njejtë ishte edhe në vitet tjera.

Libri Vjetari Statistikor i Kosovës dhe Jugosllavisë viti 1983 të burgosur në Jugosllavi mbi 21.520.

Këto 17 vite u genjye kinse Enver Hoxha na paska vrarë mijëra shqiptarë.

Migjen Kelmendi me disa po mundohen me gjuhë ta ndajnë popullin në dysh, kur dihet që gjuha shqipe ka qenë një me shekuj. Vazhdimi i unifikimit të gjuhës shqipe, më 1972 është bërë edhe me përfaqesuesit shqiptarë nga të gjitha trojet shqiptare në Jugosllavi. Gjithmonë gjuha e unifikuar ka qenë toskë e gegë, gegë e toskë. Gjuhën gegë të paunifikuar e donte Serbia tek ne në Kosovë e vise tjera shqiptare në Jugosllavi ( për mos të qenë të njejtë me popullin e Shqipërisë).

Ashtu edhe Nexhmedin Spahiu doli me shpikjen Komb Kosovar, edhe ky veproi sipas dëshirës së Serbisë, Maqedonisë, Malit të Zi dhe Greqisë, që nesër edhe shqiptarët jashtë Kosove të quhen preshevarë, tetovarë ulqinas etj.

Ju Migjen Kelmendi , Baton Haxhiu e disa nuk po e kritikoni Ahmet Zogun-legalistët dhe ballistët të cilët kanë qenë pro fashizmit dhe në aleancë me çetnikët, sikur të fitonin këta Shqipëria dhe Kosova do ti kishin punët shumë më keq. Kur dihet që A.Zogu është strehuar në Beograd dhe me forcat serbe dhe me mercenarë shqiptarë kanë hyrë në Shqipëri, e kanë rrëzuar qeverinë e Fan Nolit dhe kanë vrarë patriotë shqiptarë, për këtë dhuratë që erdhi në pushtet A.Zogu i jep Serbisë Shën Naumin, Vërmoshin dhe Pogradecin, këtë e vërteton edhe historiografia serbosllave.

Libri, Mandelët e Shqipërisë nga ballisti Agim Musta bot. në Tiranë në fillim të viteve 90'ta (nuk shkruhet data e botimit) fq.83 shkruan: Kisha dëgjuar se disa shokë të mi i kishin pushkatuar partizanët në Berat dhe në Korçë. Pra patjetër duhej të ikja...Shkodra nuk do të bjerë në duart e komunistëve, 20.000 të armatosur mund ta mbajnë atë deri sa të bëhet zbarkimi I anglo-amerikanëve që pritej dita-ditës. Nga ana tjetër edhe 10.000 çetnikë jugosllavë, me në krye Drazha Mihajloviqin kishin bërë ofertën për të ardhur në Shkodër...Në mbremje mberrimë në Podgoricë... Mbasë 20 ditësh mbërrimë në Sarajevë nga fundi I dhjetorit erdhi te ne Mehdi Frashëri...

- Ju zoterinjë Migjen, Baton, Nexhmedin e disa, nuk po i kritikoni as Koçi Xoxën, Pandi Kriston, S. Malushovën, H. Spahiun, N. Jahon, P. Islamin, P. Fidhi etj të cilët sipas diktatit të serbosllavëve dhe rusëve janë munduar ta eliminojnë Enver Hoxhën dhe ta bëjnë Shqipërinë republikë të Jugosllavisë. Emrin e Koçi Xoxës e mbanin disa rrugë qytetesh si në Beograd, Prishtinë, Ferizaj, Preshevë, Maqedoni etj. Kurse Enver Hoxhën serbosllavët mundoheshin ta eliminonin. Enver Hoxha nuk mban përgjegjësi as për Masakrën e Tivarit, as për atë të Drenicës e as për masakrat në Shqipëri që i ka bërë Mehmet Shehu sdm. gjatë luftës i cili ka qenë i kritikuar nga Enver Hoxha.

Enver Hoxha deri më 1948 thujse ka qenë minorancë ndaj Koçi Xoxës dheë Jugosllavëve, me të drejtë një bashkëpunor i tij shkruan: Po të mos ishte Enver Hoxha nuk do të kishte as Shqipëri.

Libri, Univerzitet u Pristini – u mrezi velikoalbanske strategije. Aut.Vujadin Milanovic. Bot. 1990 Beograd. Fq. 160; shkruan (në gjuhën serbokroate)... Ramiz Kelmendi ka qenë kryeredaktor në Ndërmarrjen Botuese Rilindja. Një kohë të gjatë ka qenë drejtor i Teatrit Krahinor. Në 20 vitet e fundit emri i Kelmendit nuk është gjendur në mesin e disa separatistëve udhëheqës, as që është përmendur si ekstremist në paraqitje publike... Për fat të keq poezitë e tijë nuk i kam lexuar. Përf. Citati.

urse tash R. Kelmendi nëpër medime deklaron se, kurrë nuk kamë qenë komunist dhe gjithmonë kam qenë kundër tyre.

Për fund, këto 16-17 vite patriot u bë shumëkush, kurse patriotët u diskredituan sdm. në Shqipëri edhe u burgosën.

- Shkrimi i dedikohet 100 vjetorit të Lindjës së Enver Hoxhës.

Ky shkrim i dedikohet edhe Migjen Kelmedit, Baton Haxhiut, Nexhmedin Spahiut etj, të cilët këto ditë po e njollosin me të madhe figurën e Enver Hoxhës. Këta dhe të tjerët e dinë sikur ne që Enveri ka qenë Burri më i Madh i Kombit por e kritikojnë për të hyrë në hatër të "dikujtë" dhe antikombëtarëve.

Në këtë shkrim dua ta falenderoj web faqen altoday.com, dervina.com dhe zëriytë.com, gazetën, Zëri i së Vërtetës për botimin e të gjitha shkrimeve të mia. Po ashtu falenderoj gazetën Ilira Post dhe gazetën Ndryshe nga Tirana dhe të përjavshmën Fokusi për botimin e shkrimit vitin e kaluar "Në kohën e të madhit Enver Hoxha Shqipëria ishte një ndër shtetet më të zhvilluara e të pavarura në botë, e cila u shkatërrua në mes Sali Berishës dhe tjerëve". E falenderoj edhe gazetën Kosova Sot dhe atë javore Tema, Pavarsia Neës për botimet pjesërisht të shkrimeve.

- Ky shkrim u dërgohet të gjitha medimeve, përfshirë edhe mediumet e Migjen Kelmendit dhe Baton Haxhiut.

Me respekt nga R.Megjuani,  
Prishtinë 14.10.2008